



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ _____

Datë: 10.09.2018

24.09.2019
02/048

PROCESVERBAL

i mbledhjes së I-rë (parë) urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës

Mbledhja mbahet me datë 06.09.2019 dhe filloi në ora 15:00 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 23 asambleistë, drejtorë komunalë dhe media.

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2020-2022, me theks të veçantë për vitin 2020.

Rrahim Morina: E hapi mbledhjen e I-rë urgjente për vitin 2019. Kemi të vetëm pikë të rendit të ditës. Kush është pro rendit të ditës:

Për: uanimsht

Ne sot e kemi mbajtur KPF-në dhe morëm vendim që të mbahet një mbledhje urgjente sot për shkak që projekt-buxheti duhet të votohet e të shkoj në dëgjim publik, por duhet të shkoj përmes Kuvendit.

Do t'ua lexoj nenin 61 që e parasheh Ligji i Financave Publike 03/L038; pas miratimit të propozimit të buxhetit komunal nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës deri me datën 1 shtator të vitit përkatës fiskal, duhet t'ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal. Të dhënat financiare si faturat, shpenzimet dhe financimi si dhe dokumentacioni tjetër i paraqitet në propozim-Buxhetin Komunal duhet të jetë gjithë përfshirës, transparent dhe në përputhje me Sistemin e Klasifikimit në bazën e parave të gatshme të SFQ i cili publikohet kohë pas kohe nga FMN. Propozim-Buxheti Komunal duhet të përfshijë:

- a) parashikime dhe supozime ekonomike dhe buxhetore;
- b) vlerësime të përgjithshme të të ardhurave nga të gjitha burimet, duke përfshirë (i) grantet, në përputhje me shumat e këshilluara në qarkoren(t) buxhetore të nxjerra nga Ministri, (ii) ndihmën nga burimet jashtë Kosovës, dhe (iii) të ardhurat e parashikuara vetanake të komunës;
- c) një cak të përgjithshëm të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimit;
- d) vlerësime të përkrahjes së pritur nga donatorët; dhe
- e) çfarëdo të dhëna të tjera me rëndësi materiale për buxhetin të cilat ZKF e konsideron të arsyeshme për t'u përfshirë.

61.2 Pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës. Pas këtyre dëgjimeve, Kuvendi Komunal, deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, duhet të shqyrtojë, ndryshojë siç e shihet të nevojshme ose të arsyeshme si dhe të miratojë dhe t'ia dorëzojë Ministrit propozim-buxhetin Komunal.

61.3 Buxheti i miratuar Komunal duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji dhe udhëzimet e dhëna në qarkoret buxhetore të nxjerra nga Ministri.

Këtë deshta ta saqrojë që për herë të parë Kuvendi Komunal e bënë dëgjimin publik. Ne e kemi përgatitur një orar të votuar në KPF dhe do ta bëjmë publik me kryetarët e fshatrave nëpër të gjitha fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës.


Propoqoj që mos të debatojmë por t'ja japim vizën këtij Projekt-Buxheti për dëgjime publike.

Kush është për që propozim-buxheti për vitin 2020-2022 me thes të veçant viti 2020?

Për: uanimsht.

Ju falemnderit për pjesëmarrje me kaq këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 15:20

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi


Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina
